

VENDIM
Nr. 425, datë 27.5.2020

**PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME
LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË
PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE
PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE**

(Ndryshuar me VKM nr. 560, datë 15.7.2020; nr. 708, datë 4.11.2022; nr. 581, datë 11.10.2023; nr. 505, datë 10.9.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Investimet me fonde publike në pasuritë kulturore kryhen nga subjekte të licencuara për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, në pasuritë kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Përzgjedhja e subjekteve për kryerjen e investimeve në pasuritë kulturore me fonde publike kryhet nëpërmjet konkurrimit publik, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim, nga:

- a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore;
- c) institucione të tjera shtetërore.

3. Institucionet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, kryejnë investime me fonde publike pas marrjes së autorizimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

II. PROCEDURA E KONKURRIMIT PUBLIK PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE

1. *Institucioni/autoriteti kontraktor, që disponon fondin publik për hartimin e projektit të ndërhyrjes, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuri kulturore, fillon procedurat e konkurrimit publik, me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Konkurrimit (në vijim Komisioni) i cili përbëhet nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.*

2. *Procedurat e konkurrimit publik kryhen nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik (në vijim “NJHDKP”) dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.*

3. Njësia e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik përbëhet nga tre anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) një jurist;
- b) një ekonomist;
- c) një specialist i fushës së trashëgimisë kulturore.

4. Në njësinë e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik mund të caktohen specialistë nga institucione të specializuara të trashëgimisë kulturore.

5. *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave* përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore. Kryetari i Komisionit përzgjidhet ndërmjet punonjësve me funksion drejtues të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën.

6. Në *Komisionin e Vlerësimit të Ofertave*, institucioni/autoriteti kontraktor, që kryen procedurën e konkurrimit publik, mund të kontrakttojë ekspertë të jashtëm në rast të mungesës së personelit ose kur mungojnë njohuritë e specializuara në fushën ku kërkohet të zhvillohet procedura.

7. Juristi i Komisionit administron të gjithë dosjen e procedurës dhe asiston *Komisionin e Vlerësimit të Ofertave*, pa të drejtë vote.

8. Anëtarët e Komisionit, në përmbushje të detyrës dhe të përgjegjësisë së tyre, deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

9. Institucioni/autoriteti kontraktor, që zhvillon procedurën e konkurrimit, urdhëron hapjen e procedurës për zhvillimin e konkurrimit publik, që përmban:

- a) të dhënat për pasurinë kulturore dhe kategorizimin e saj, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- b) llojin e investimit/shërbimit përkatës;
- c) fondin limit të parashikuar;
- ç) përbërjen dhe emrat nominativë të anëtarëve të Komisionit;
- d) pasaportën e pasurisë kulturore/monumentit të kulturës, të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK).

9/1 Përfundimisht, në rastet e situatave emergjente dhe kur nga zbatimi i procedurës dhe afatëve të parashikuara në këtë vendim rrezikohet gjendja e pasurive kulturore, autoriteti kontraktor shoqëron urdhrin e konkurrimit me relacionin argumentues mbi ekzistencën e situatës emergjente për ndërhyrje në pasuri kulturore, e cila nuk duhet të jetë shkaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

10. Njësia e hartimit të dokumenteve përgatit dokumentet e procedurës së konkurrimit publik, të cilat miratohen nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor dhe përmbajnë informacionin, si më poshtë vijon:

- a) Njoftimin për konkurrimin publik;
- b) Projektin e ndërhyrjes të miratuar nga KKTKM-ja dhe specifikimet teknike, me përjashtim të procedurës së konkurrimit për projektim;
- c) Kriteret e ndërhyrjes dhe/ose termet e referencës;
- ç) Preventivin me zërat e shërbimit/punimeve, vëllimet përkatëse, afatin, si dhe grafikun e kryerjes së tyre, me përjashtim të procedurës së konkurrimit për projektim;
- d) Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e subjektit fitues;
- dh) Dokumentacionin ligjor, financiar dhe teknik që duhet të paraqesin ofertuesit, sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentet e procedurës;
- e) Datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave;
- ë) Udhëzimet e nevojshme për ofertuesit;
- f) Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

11. Dokumentet standarde të procedurës së konkurrimit publik miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përdoren nga të gjitha institucionet/autoritetet kontraktore që realizojnë procedura konkurrimi, sipas këtij vendimi.

12. Njoftimi për konkurrimin publik përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) institucionin që zhvillon konkurrimin publik;
- b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit;
- c) llojin e shërbimit/punës;
- ç) fondin limit të procedurës së konkurrimit publik;
- d) afatin e realizimit të shërbimit/punimeve;
- dh) afatin dhe mënyrën për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik;
- e) datën, orën dhe vendin e dorëzimit dhe të hapjes së ofertave;
- ë) dokumentacionin që duhet të paraqesin ofertuesit.

13. Njoftimi për konkurrim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen elektronike të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara dorëzimit të ofertave për procedurat me fond limit mbi 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, ndërsa për procedurat me fond limit, deri në 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, njoftimi publikohet të paktën 8 (tetë) ditë para.

13/1. Në rastet e situatave emergjente, sipas parashikimit në pikën 9/1, njoftimi për konkurrim publik publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen elektronike të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, të paktën 3 (tri) ditë përpara dorëzimit të ofertave;

14. Kriteret për kualifikimin e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore janë, si më poshtë vijon:

- a) të jetë person fizik/juridik ose organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar;
- b) të ketë përmbushur detyrimet tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore;
- c) të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike;
- ç) të mos jetë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- d) të mos jetë në ndjekje penale ose i dënuar me një vendim të formës së prerë;
- dh) të ketë përmbushur detyrimet për taksat vendore;
- e) të provojë që ka aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, që institucioni vlerëson të nevojshme;
- ë) të jetë i licencuar për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, në pasuritë kulturore, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore në varësi të objektit të konkurrimit;
- f) të ketë përvojë të mëparshme deri në 50% të vlerës së projektit të miratuar nga KTKM-ja në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse të projektimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuritë kulturore;
- g) çdo kriter tjetër teknik që provon aftësitë teknike për të realizuar shërbimet/punimet e kërkuara, në bazë të të dhënave të përcaktuara në dokumentacionin për konkurrim, që institucioni i vlerëson të nevojshme.

14/1 Kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "dh" plotësohen me vetëdeklarim të ofertuesit. Fituesi i procedurës së konkurrimit publik dorëzon dokumentacionin origjinal ose kopje të njëzuar me origjinalin para lidhjes së kontratës.

15. Subjektet e huaja lejohet të konkurrojnë vetëm në procedurat për hartim të projektit/projekteve të zbatimit, duke plotësuar kriteret, si më poshtë vijon:

- a) të jenë të regjistruar në vendin e tyre për hartimin e projektit/projekteve të zbatimit, në pasuri kulturore;
- b) të provojnë që kanë aftësi financiare për të realizuar objektin e procedurës së konkurrimit të shpallur nga institucioni;
- c) të vërtetojnë me dokumentacionin përkatës që plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentacionin e konkurrimit;
- ç) të provojnë se kanë në stafin e tyre një projektues, i cili është i licencuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

16. Dokumentacioni i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i njëzuar me origjinalin nga noteri.

17. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Në çdo rast, Komisioni duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit për përmbushjen e këtyre kriterëve.

18. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punimeve/shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kriteret sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit.

18/1. NJHDKP-ja, në çdo kohë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbarimit të afatit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e saj ose në përgjigje të një kërkesë nga një subjekt i interesuar, mund t'i ndryshojë dokumentet e konkurrimit, duke e dokumentuar këtë ndryshim me 1 shtojcë, e cila bëhet pjesë e dokumentacionit të konkurrimit dhe u njoftohet subjekteve. Nëse NJHDKP-ja e konstaton të nevojshme të ndryshojë dokumentet e konkurrimit dhe kjo ndodh më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbarimit të afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, mund të vendosë të shtyjë datën e zhvillimit të konkurrimit publik, me jo më shumë se 5 (pesë) ditë nga data e publikuar në fillim. Shtojcat publikohen në faqen elektronike të autoritetit kontraktor dhe Buletinin e Njoftimeve Publike.

19. Komisioni i Vlerësimit hap ofertat ekonomike në datën, vendin dhe orën e caktuar në njoftimin për konkurrim në prani të të gjithë ofertuesve të pranishëm. Kryetari lexon ofertat ekonomike të paraqitura nga ofertuesit dhe dokumentacionin shoqërues. Procesverbali i hapjes së ofertave firmoset nga të gjithë të pranishmit. Ofertat ekonomike nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së vlerësimit.

20. Subjekti, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim ose nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e procedurës së konkurrimit, shkualifikohet.

21. Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur vetëm një ofertë e vlefshme. Ofertë e vlefshme konsiderohet oferta që nuk mund të shkualifikohet, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

22. *Oferta fituese përcaktohet sipas çmimit më të ulët ose sipas konceptit "oferta më e favorshme", duke u bazuar në kombinimin e elementeve teknike dhe ekonomike. Për vlerësimin e propozimeve teknike dhe ekonomike përdoren kriteret dhe metoda të përcaktuara në dokumentet standarde të konkurrimit publik.*

22/1. *Pas hapjes së ofertave, Komisioni mund të anulojë procedurën, në rastet kur:*

- a) *nuk është paraqitur asnjë ofertë;*
- b) *nuk është kualifikuar asnjë ofertë e vlefshme;*
- c) *ofertuesi/ofertuesit i/e kualifikuar tërbiqen para lidhjes së kontratës ose nuk pranon/jnë të bëj/ në sigurimin e kontratës;*

ç) *për arsye dhe shkaqe që nuk varen nga vullneti i institucionit/autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës.*

Komisioni nuk mban përgjegjësi për vendimin e marrë, në bazë të kësaj pike, ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta. Vendimi u komunikohet të gjithë ofertuesve, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij, bashkë me arsyet. Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit të anulimit bëhet njoftimi në të njëjtën mënyrë siç është bërë edhe njoftimi i kontratës.

22/2. *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

22/3. *Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.*

23. *Komisioni e Vlerësimit të Ofertave shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Për procedurat e konkurrimit publik, deri në 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit shqyrtohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga NJVO-ja. Procesi i vlerësimit dokumentohet në një procesverbal dhe nënshkruhet nga anëtarët. Pas përfundimit të shqyrtimit, titullari i institucionit që zhvillon procedurën njofton në formë shkresore dhe me postë elektronike ofertuesit pjesëmarrës për renditjen dhe vlerësimin e secilit prej tyre.*

23/1. *Procedurat përzgjedhëse të subjekteve të pajisura me licencë për projektim janë procedura konkurrimi me faza.*

23/2. *Për procedurat e konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara në mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve në pasuritë kulturore dhe fondi limit i përlllogaritur nuk i kalon 100 000 (njëqind mijë) lekë, përzgjedhja e subjekteve bëhet me tri oferta, pa procedurë, nga një komision i përbërë nga tre anëtarë.*

23/3. *Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 9/1, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 2 (dy) ditëve nga dita e hapjes së ofertave.*

24. *Ankimi për procedurën e konkurrimit publik bëhet fillimisht te titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmeja e marrjes dijeni të vendimit. Në rastin kur ankimi nuk pranohet ose subjekti nuk merr përgjigje brenda afatit për ankesën e tij, ka të drejtë të bëjë ankim te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, brenda afateve të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur procedura e konkurrimit zhvillohet nga organi i vetëqeverisjes vendore, në administrimin e të cilit ndodhet pasuria kulturore.*

24/1. *Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 9/1, ankimi për procedurën e konkurrimit publik bëhet te titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën brenda 2 (dy) ditëve nga e nesërmeja e marrjes dijeni të njoftimit.*

25. *Pas përfundimit të afatit të ankimit, nëse nuk ka pasur ankesa, sipas pikës 24, të këtij kreu, institucioni që zhvillon procedurën e konkurrimit njofton fituesin për lidhjen e kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi. Njoftimi i fituesit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban informacionin, si më poshtë vijon:*

- a) *emrin e fituesit dhe adresën;*
- b) *vlerën e ofertës fituese;*

- c) emrat e ofertuesve të tjerë pjesëmarrës dhe vlerat përkatëse të ofertave të tyre;
- ç) afatin e lidhjes së kontratës;
- d) sigurimin e kontratës që fituesi duhet të bëjë për llogari të institucionit që ka në dispozicion fondet publike, si garanci për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

25/1. Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 13/1, njoftimi i fituesit për lidhjen e kontratës kryhet brenda 1 (një) dite nga njoftimi.

III. SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV

1. Me paraqitjen e ankimit të titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, sipas afatit të përcaktuar në pikën 24, të kreut II, të këtij vendimi, procedura pezullohet. Pas paraqitjes së ankimit, titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, urdhëron ngritjen e një Komisioni, i cili shqyrton ankimin dhe merr vendim të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e ankesës. Anëtarët që caktohen në Komisionin e shqyrtimit të ankimit, nuk duhet të kenë qenë pjesë e Komisionit të procedurës për të cilën bëhet ankimi.

2. Vendimi i njoftohet ankuesit jo më vonë se ditën vijuese të punës, në formë shkresore dhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës.

3. Titullari i institucionit/autoriteti kontraktor që zhvillon procedurën vendos:

- a) të mos pranojë ankimin;
- b) të pranojë pjesërisht ankimin;
- c) të pranojë plotësisht ankimin.

4. Në çdo rast, vendimi i titullarit të institucionit/autoritetit kontraktor është i arsyetuar.

5. Në rastin kur titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën nuk e pranon ankimin, e pranon pjesërisht atë ose nuk kthen përgjigje brenda afatit për shqyrtimin e ankesës, subjekti i interesuar ka të drejtë të ankohet te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmbja e marrjes dijeni të vendimit ose e përfundimit të afatit për të kthyer përgjigje nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor. Një kopje e ankimit dorëzohet njëkohësisht edhe tek institucioni i cili zhvillon procedurën e kokurimit publik.

6. Me paraqitjen e ankimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, procedura mbetet e pezulluar deri në përfundimin e shqyrtimit të tij nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Brenda 3 (tri) ditëve nga e nesërmbja e marrjes dijeni të ankimit, titullari i institucionit/autoritetit kontraktor përcjell dokumentacionin që vlerëson të nevojshëm për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Pas paraqitjes së ankimit, ministri urdhëron ngritjen e Komisionit, i cili shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit pranimin ose mospranimin e ankimit. Shqyrtimi i ankimit përfundon brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e ankesës. Në rast se titullari i institucionit/autoritetit kontraktor nuk ka paraqitur informacionin e kërkuar ose e ka sjellë atë jo të plotë, ankimi shqyrtohet bazuar në informacionin që disponohet nga Komisioni i ngritur nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, ministri, me urdhër, vendos:

- a) të mos pranojë ankimin;
- b) të pranojë pjesërisht ankimin;
- c) të pranojë plotësisht ankimin.

7. Urdhri i ministrit për pranimin ose mospranimin e ankimit i njoftohet ankuesit dhe institucionit/autoritetit kontraktor jo më vonë se ditën vijuese të punës në formë shkresore dhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tyre.

8. Urdhri i ministrit për pranimin ose mospranimin e ankimit mund të kundërshtohet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon vazhdimin e procedurës.

9. Nëse ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore nuk shprehhet me vendim brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, afati për t'iu drejtuar gjykatës fillon nga e nesërmbja e përfundimit të afatit për marrjen e vendimit nga ministri.

10. Në rastin kur përzgjedhja e subjekteve për kryerjen e investimeve me fonde publike kryhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, procedurat e ankimit zhvillohen sipas parashikimeve të pikave 1, 2 3, 4, 8 dhe 9, të këtij kreu.

11. Në rastin e zhvillimit të procedurave të konkurrimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, vendimi i marrë nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor, sipas pikës 3 të këtij kreu, është përfundimtar nga ana administrative.

IV. KONTRATA PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE/PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET E DETYRUARA RUAJTËSE

1. Kontrata për realizimin e shërbimeve/punimeve për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse lidhet brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, pasi është paraqitur edhe sigurimi i kontratës, në masën 10% të vlerës së ofertës fituese.

2. Kontrata përmban të dhëna, për:

a) përshkrimin e detajuar të pasurisë kulturore që është objekt i shërbimeve/punimeve për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse dhe vendndodhjen e tij;

b) kategorizimin e pasurisë kulturore, në bazë të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

c) llojin e shërbimeve/punimeve;

ç) projektin e miratuar në KKTKM (në rastin e punimeve të zbatimit);

d) preventivin dhe grafikun e punimeve (në rastin e punimeve të zbatimit);

dh) çmimin e kontratës;

e) kohëzgjatjen e kontratës;

ë) garancinë e punimeve (në rastin e punimeve të zbatimit);

f) të drejtat dhe detyrimet e palëve;

g) kushte të tjera, të përcaktuara në dokumentet e procedurës.

2/1. *Modifikimi i kontratës, pa zhvilluar një procedurë të re konkurrimi, gjatë afatit të zbatimit të saj, kryhet kur është bërë i nevojshëm, për shkak të rrethanave të paparashikuara nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike të konkurrimit. Modifikimi i kontratës kryhet për një kontratë që është ende në zbatim, për zëra që janë bërë të domosdoshëm për zbatimin e saj. Nga autoriteti kontraktor mund të bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme me kusht që vlera e tyre të mos kalojë 25% të vlerës së kontratës. Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës dokumentohen nga autoriteti kontraktor.*

2/2. *Autoriteti kontraktor cakton ndjekësin e kontratës, si person përgjegjës, i cili do të mbajë marrëdhëniet ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit.*

3. Pas përfundimit të punimeve, kartelës së pasurisë kulturore, objekt i ndërhyrjes detyruese ruajtëse, i përditësohen të dhënat mbi ndërhyrjet e kryera dhe regjistrohen në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 216, datë 18.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për restaurimin e monumenteve të kulturës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe institucionet publike që kanë në administrim pasuri kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama